

EPPC Albania kërkon 2 *Përfaqësues Shitjesh nga telefoni* për klientin e saj, **një ndër institucionet financiare kredidhënëse më të mëdha në vend.**

Përfaqësuesi i shitjeve është përgjegjës për promovimin dhe shitjen e produkteve tek klientët nëpërmjet telefonit në mënyrë etike dhe profesionale.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Promovon dhe prezanton shërbimet dhe produktet e kompanisë nëpërmjet telefonit tek klientët;
- Shpjegon produktet/shërbimet duke përdorur një gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme dhe miqësore me klientët;
- Kujdeset ti përgjigjet në mënyrë pozitive dhe profesionale të gjitha pyetjeve apo paqartësive të klientëve në lidhje me shërbimet që kompania ofron;
- Kontakton dhe informon klientët në lidhje me shërbime apo fushata të reja të lancuara nga kompania.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare;
- **Përvojë e mëparshme pune në shitje nga telefoni (përbën avantazh);**
- Njohuri të mira kompiuterike (**MS Office**);
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe interpersonale;
- Të jetë bindës, i orientuar drejt rezultateve dhe drejt marrëdhënieve me klientin;
- **Fleksibilitet për të punuar me turne.**

Të dhënat:

Pozicioni: Përfaqësues shitjesh nga telefoni;
Vendndodhja: Tiranë;
Pagesa: Shumë e mirë; (*fikse dhe bonuse*)
Aplikimet mbyllen: 02.09.2018.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail-it:

neila.hoxha@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.